



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut
Nënkomisioni për të Drejtat e Njeriut*

PROCESVERBAL

Tiranë, më 12.04.2019, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Vasilika Hysi – kryetare e Nënkomisionit

Xhemal Qefalia – anëtar i nënkomisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i kalendarit dhe planit të masave/aktiviteteve për zbatimin e plan veprimit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e rekomandimeve të raportit të Komisionit Europian për Shqipërinë si dhe në kuadër të Rezolutës së Kuvendit për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm OKB prill –dhjetor 2019.

2. Miratimi i planit të veprimit për periudhën prill – tetor 2019 për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga rezoluta “Për njohjen dhe mbështetjen e veprimtarisë së mbrojtësve të të drejtave të njeriut në promovimin, nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, forcimin e shtetit të së drejtës dhe konsolidimin e demokracisë”.

3. Seancë dëgjimore me kandidatët për anëtarët e Shqipërisë pranë Komitetit Europian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Degradues (CPT).

Marrin pjesë:

Vasilika Hysi, Eglantina Gjermani, Xhemal Qefalia, Jurgis Çyrbja, Ervin Bushati dhe Klotilda Bushka

Të ftuar:

Znj. Luljeta Ikonimi Caraoshi

Te ftuar

➤ **Ministria e Drejtësisë:**

1. Z. Edis Ibrahim Këshilltar i Ministrit

- **Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale:**
 - 2. Znj. Bardhylka Kospiri, Zevendesministre e Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale;
 - 3. Znj. Denada Seferi, Drejtore
- **Ministria e Brendshme:**
 - 4. Znj. Romina Kuko, Zevendesministre
- **Avokati i Popullit:**
 - 5. Z. Enio Haxhimihali, Drejtor Kabineti
- **Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi:**
 - 6. Znj. Ardiana Hala
- **Prezenca e OSBE ne Tirane:**
 - 7. Znj. Albana Jorganxhi, keshilltare Ligjore
- **Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës**
 - 8. Z. Ilir Rusi, pedagog
- **Fakulteti i Gjuheve te Huaja, Universiteti i Tiranës:**
 - Departamenti i Gjuhes Angleze**
 - 9. Znj. Esmeralda Subashi
 - 10. Znj. Rozana Bela
 - Departamenti i Gjuhes Frenge:**
 - 11. Znj. Fjoralba Dado
- **Komiteti Shqiptar i Helsinkit:**
 - 12. Znj. Ardita Kolmarku
- **Shoqata Avokatet Penaliste:**
 - 13. Z. Sajmir Vishaj, kryetar
- **Qendra Shqiptare e Rehabilitimit të Traumës dhe Torturës:**
 - 14. Dr. Anita Pilika, psikiatre
 - 15. Zj. Afrodhiti Zejno, psikologe
 - 16. Zj. Fatmira Lato, jurist
- **CRCA Albania:**
 - 17. Zj. Linda Pino
- **UNICEF Albania:**
 - 18. Znj. ErmiraShkurti, Specialiste e Drejtesise per te Mitur ne zyren e UNICEF-it.
- **Koalicioni "Drejtësi për të gjithë":**

19. Znj. Blerina Balilaj Brovina, ËDN Albania

➤ **Qendra për Nisma Ligjore dhe Qytetare**

20. Znj. Kejsi Ziu.

Kandidatët:

Arta Mandro, Aurel Borici, Brunilda Menella, Drita Avdyli, Erinda Bllaca Ndroqi, Helena Papa, Luljeta Ikonomi Caraoshi.

HAPET MBLEDHJA

Vasilika Hysi – Përshëndetje!

Mirë se erdhët!

Sikurse jeni në dijeni, në Komitetin European për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin Johuman dhe Degradues, pranë Këshillit të Europës, është krijuar një vend vakant për shkak të mbarimit të mandatit të përfaqësuesit të Shqipërisë pranë këtij komiteti. Gjatë kësaj periudhe Asambleja Parlamentare e KE-së i ka adresuar një letër kryetarit të Delegacionit Parlamentar në Asamblenë Parlamentare e KE-së, zotit Ervin Bushati, ku ka kërkuar ndërmarrjen e një procesi të hapur, transparent dhe gjithëpërfshirës lidhur me plotësimin e kësaj vakance. Në bazë të shkresës së adresuar nga delegacioni ynë në Asamblenë Parlamentare të KE-së u ngarkua Kuvendi i Shqipërisë dhe më konkretisht, Nënkomisioni për të Drejtat e Njeriut për të kryer këtë procedurë.

Ne kemi diskutuar gjerësisht për procedurën që do të ndiqnim dhe për të përcjellë pranë Komitetit të Ministrave të KE-së 3 kandidaturat më të mira nga ky proces. Për informacion, çdo shtet anëtar i KE-së ka një përfaqësues pranë këtij organi monitorues. Mandati i përfaqësuesit është 4 vjet me të drejtë rizgjedhjeje. Komiteti European për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin Çnjerëzor dhe Degradues kryen misione monitorimi në vendet anëtare të Këshillit të Europës dhe monitoron respektimin e lirive dhe të drejtave të personave të privuar nga liria në stacionet e policisë, në burgje, në qendrat e paraburgimit, në qendrat e ndalimit të emigracionit, në spitalet psikiatrike dhe në shtëpitë e kujdesit social. Efekti është shumë e gjerë, jo thjesht për personat, të cilëve u privohet liria për shkak të veprimeve që bëjnë në kundërshtim me ligjin, por edhe për shkak të rrethanave të ndryshme.

Statusi i këtyre ekspertëve është shumë i lartë. Ata kanë një mbrojtje të veçantë në raport me shumë anëtarë të tjerë, që ka KE-ja.

Ne e diskutuam procedurën dhe këtë procedurë e bëmë publike, duke pasur parasysh rezolutën nr. 1540 të Asamblesë Parlamentare të KE-së “Për përmirësimin e procedurave për anëtarët e CPT-së”.

Ndërkohë, ne kemi respektuar një për një kërkesat e kësaj rezolute. Për transparencë për ju dhe për publikun.

E para, është kërkuar që thirrja të jetë publike dhe kandidaturat që prezantohen të jenë meshkuj dhe femra.

E dyta, këshillimi për kandidatët e përshtatshëm për organet përkatëse me organet qeveritare dhe ato joqeveritare. Na është këshilluar të kemi këshillime me ministrinë e

Drejtësisë, atë të Shëndetësisë, me ministrinë që është përgjegjëse për punët e brendshme, me DAP-in, institucionet akademike, organizatat e shoqërisë civile, që janë aktive në luftën kundër torturës dhe në ndihmë të të burgosurve. Faza e parë është zhvillimi i intervistave për të vlerësuar kualifikimet e tyre, motivimin dhe disponibilitetin dhe aftësinë në gjuhën angleze ose franceze, pra një nga gjuhët e KE-së, mundësisht nga një panel i pavarur. Për transparencë, ne kemi i dërguar nëpërmjet sekretarit të Përgjithshëm një shkresë zyrtare Fakultetit të Gjuhëve të Huaja.

Në këtë panel janë të pranishëm pedagogët e Departamentit të Gjuhës Angleze dhe Departamentit të Gjuhës Frënge.

Gjithashtu, është një model standard aplikimi i kërkuar, të cilin e ka publikuar Sekretariati i KE-së.

Të nderuar përfaqësues të pranishëm,

Të nderuar deputetë, anëtarë të Nënkomisionit për të Drejtat e Njeriut,

Në këtë proces të intervistës së parë është mbajtur në konsideratë përveç rezolutës nr. 1540/2007, edhe dy rezoluta të tjera, konkretisht, rezoluta nr. 1248/2001 dhe rezoluta nr. 2160/2017 e Asamblesë Parlamentare të KE-së, e cila kërkon që listat e kandidatëve të Kuvendit, pasi të vlerësohen nga komisioni përkatës, t'i përcillen Byrosë së Asamblesë Parlamentare të KE-së. Pra, është lista preferenciale e bazuar në meritë dhe në plotësim të kriterëve. Më pas Byroja e shqyrton atë dhe e voton Komiteti i Ministrave i KE-së.

Lidhur me procedurën e ndjekur, Kuvendi i Shqipërisë e ka bërë publike thirrjen më datë 13 mars 2019. Në faqen zyrtare të Kuvendit është thirrja zyrtare, ku i ka kërkuar kandidatëve që plotësojnë kriteret e caktuara, të aplikojnë. Janë disa kriteret:

1. Të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare në një nga fushat si drejtësia, mjekësia, psikologjia, shkenca sociale me diplomë Master Shkencor ose me studime jashtë vendit, duke fituar një diplomë të barasvlershme me të. Të gjithë ata që kanë mbaruar me sistemin e vjetër, i cili barazohet me Masterin Shkencor.

2. Të ketë integritet moral dhe profesional, të ketë përvojë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

3. Të ketë të paktën 10 vjet përvojë profesionale aktive në një nga fushat e mësipërme;

4. Të mos jetë është i dënuar me vendim penal të formës së prerë;

5. Të zotërojë shumë mirë, me shkrim dhe me gojë një nga gjuhët zyrtare të Këshillit të Europës (anglisht ose frëngjisht);

Krahas kërkesës me shkrim, kandidatët duhet të paraqesin brenda datës 28 mars 2019 dokumentet e mëposhtme:

a) CV-në e përditësuar sipas modelit të kërkuar nga Sekretariati i KE-së në gjuhën anglisht ose frëngjisht;

b) Kopje e noterizuar e diplomës/diplomave së arsimit të lartë dhe të studimeve pasuniversitare, të titujve ose gradave shkencore në fushën përkatëse, të punimeve në fushën përkatëse nëse ka;

c) Kopje e noterizuar e librezës së punës, që vërteton përvojën në një nga fushat e kërkuara;

d) Vërtetim të gjendjes gjyqësore;

e) Formularin e vetëdeklarimit të plotësuar dhe nënshkruar, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

f) Dy rekomandime nga përfaqësues të institucioneve të pavarura ose organizata të shoqërisë civile, që veprojnë në fushën e të drejtave të njeriut.

Më 1 prill 2019, në përfundim të fazës së parë të procedurës së përzgjedhjes së anëtarit të Shqipërisë pranë këtij komiteti, Kuvendi ka bërë publike në rend alfabetik listën e kandidatëve, që iu përgjigjën thirrjes, të cilët janë zonjat dhe zotërinjtë e mëposhtëm: zonja Arta Mandro, zoti Aurel Boriçi, zonja Brunilda Menella, zonja Drita Avdyli, zonja Erinda Bllaca Ndroqi, zonja Helena Papa, zonja Luljeta Ikonimi Çaraoshi.

Gjithashtu, në datën 04.04.2019 Kuvendi njoftoi në faqen zyrtare të tij se Nënkomisioni Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, në bashkëpunim me delegacionin e përhershëm të Kuvendit pranë Asamblesë Parlamentare, do të vijojë procedurat e përzgjedhjes dhe, konkretisht, që në atë datë është njoftuar dita e sotme. Pra, sot në rendin e ditës kemi seancën e hapur publike të përzgjedhjes paraprake të kandidatëve, e cila, sikurse e shikoni, është e hapur edhe për publikun.

Ne ju kemi ftuar të gjithëve ju këtu, ndaj jeni të lutur që, në kuadrin e transparencës dhe të forcimit të mekanizmave për të pasur një përzgjedhje sa më të mirë të kandidatëve, mund të drejtoni pyetje dhe mendime.

Ndërkohë, ju bëj me dije se në adresën zyrtare të sekretarisë së Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut kanë ardhur edhe letra mbështetëse për kandidatë të veçantë nga institucione ose organizata të të drejtave të njeriut.

Për transparencë, të nderuar kolegë, në përfundim të dëgjësës me kandidatët ose kandidatet, pas vlerësimit të kualifikimit të tyre, motivimeve dhe disponibilitetit, një punë që kërkon angazhim të madh, pasi ka shumë vizita monitoruese, por jo në vendin e vet, sepse, si rregull, nuk monitorohet vendi nga vjen kandidati, do të hartohet një listë me tre kandidatët e

përzgjedhur që plotësojnë kriteret sipas standardeve të CTP-së, e cila në fund do t'i përcillet sekretariatit të Asamblesë Parlamentare për të vijuar me procedurën e mëtejshme.

Gjithashtu, të nderuar kolegë, ju bëj me dije se nënkomisioni u ka dërguar një kërkesë zyrtare, fillimisht me e-mail dhe më pas me letër, të gjitha institucioneve që kanë lidhje me funksionin e Komitetit European për Parandalimin e Torturës, nga të cilët kanë konfirmuar pjesëmarrjen si më poshtë: nga Ministria e Drejtësisë, zoti Edis Ibrahim, këshilltar i ministrit; nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, zonja Bardhylka Kospiri, zëvendësministre, e cila shoqërohet nga një kolege; nga Avokati i Popullit zoti Enio Haxhimihali, drejtor kabineti; nga Ministria e Brendshme zonja Romina Kuko, zëvendësministre; nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi zonja Ardiana Hala; nga prezenca e OSBE-së në Tiranë, zonja Alba Simoni Jorganxhi, këshilltare ligjore; nga Fakulteti i Drejtësisë zoti Ilir Rusi, pedagog; nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja (UT), nga Departamenti i Gjuhës Angleze, zonjat Esmeralda Subashi dhe Rozana Bela, kurse nga Departamenti i Gjuhës Frënge, zonja Fjoralba Dado; nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit zonja Ardita Kolmarku; nga Shoqata e Avokatëve Penalistë, zoti Saimir Vishaj, kryetar; nga Qendra Shqiptare e Rehabilitimit të Traumës dhe Torturës, zonjat doktoresha Anita Pilika, psikiatre, zonja Afrodhiti Zeno, psikologe, si dhe zonja Fatmira Lato, juriste. Ndërkohë, nga organizatat: “CRCA – Albania” kemi zonjën Linda Pino dhe zotin Altin Hazizaj; nga “UNICEF – Albania” kemi zonjën Ermira Shkurti, specialiste e Drejtorisë për të Miturit. Ju lutem, zonja Shkurti, zini vend!

Nga koalicioni “Drejtësi për të gjithë”, që është edhe një nga partnerët kryesorë në Kuvend për të gjithë procesin e reformave të mëdha të drejtësisë, zonja Blerina Balilaj Brovina, si dhe nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, zonja Kejsi Ziu.

Nuk e di nëse ka persona të tjerë, të cilët nuk kanë deklaruar ose unë nuk ua lexova emrat.

Gjithashtu, të nderuar kolegë, dua t'ju bëj me dije se unë drejtoj Nënkomisionin për të Drejtat e Njeriut dhe, në bazë të Kodit të Sjelljes, jam e detyruar të shmang çdolloj konfliktin e interesit në dukje ose rast pas rasti.

Ndaj meqenëse kandidatët i njoh për shkak të angazhimit tim në punë, unë nuk do të marr pjesë në procesin e vlerësimit dhe të përzgjedhjes së shortlistës, pasi do të doja të shmangia çdo paragjykim. Mendimet kanë qenë të ndryshme nëse jam ose jo në konfliktin e interesit, por për të shmangur çdo ekuivok, meqenëse në Shqipëri është zakoni që mund të përflitesh, drejtimin e mbledhjes së këtij komisioni do t'ia lë njërit prej kolegëve, i cili nuk ka lidhje me kandidatët, zotit Xhemal Qefalia.

Ndërkohë, pjesën e dytë të mbledhjes, e cila ka të bëjë me planin e veprimit për periudhën prill – tetor 2019 për zbatimin e rezolutës “Për mbrojtësit e të drejtave të njeriut” dhe për angazhimin e komisionit në çështjet e integritit europian dhe Axfordës 2030 do ta drejtoj vetë, pra pas mbarimit të këtij procesi dhe të ftuarit të jenë larguar.

Besoj se më mirëkuptoni, pasi nuk do të doja që lista e kandidatëve, që është shumë e mirë, për herë të parë na vijinë kandidatë shumë të mirë, të skualifikohet për shkak se dikush mund të thotë që e drejtoi mbledhjen një kandidate që njeh kandidatët.

Faleminderit!

Xhemal Qefalia – Për procedurë.

Zonja Vasilika, nuk e kam ndërhyrjen pse ishte emri im aty, sepse nuk ka asgjë, është diçka normale, mund të ishte edhe emri i një kolegu tjetër, por problemi është që mua më duket pa sens vendimmarrja juaj, pasi mendoj që njohje me kandidatët nuk mund të keni vetëm ju, mund të kenë edhe kolegë të tjerë, por ju jeni edhe në cilësinë e kryetares së Nënkomisionit për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, jeni edhe nënkryetare e Kuvendit.

Unë mendoj që, nisur nga autoriteti dhe prestigji i kësaj vendimmarrjeje, nuk keni pse ta ndërmerri një veprim të tillë, nuk e di nëse kolegët e mi të nënkomisionit kanë ose jo të njëjtin mendim.

Domethënë, duke qenë se ju tashmë nuk jeni pjesë e organizatave jofitimprurëse, pavarësisht karrierës suaj, ku keni drejtuar Komitetin Shqiptar të Helsinkit dhe keni njohje me kolegët e pranishëm në sallë, mendoj se është në autoritetin e këtij nënkomisioni që drejtimin e mbledhjes ta vazhdoni ju.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Unë do ta marr drejtimin e mbledhjes në pjesën e dytë të saj. Është një vendim që unë e vlerësoj. Nuk është konflikt, por mund të duket për dikë tjetër. Nuk do të doja që Shqipëria dhe kandidatët, të cilët i kemi shumë të mirë, të ndëshkoheshin për shkak të një gjëje formale. Besoj se biem dakord. Unë kërkova mirëkuptimin e të gjithëve ju.

Xhemal Qefalia – Sipas procedurës që lexoi kryetarja e nënkomisionit, zonja Vasilika, do të procedojmë sipas rendit alfabetik. E para në listë është zonja Arta Mandro.

Eglantina Gjermani – Dua të bëj dy njoftime. Njoftimi i parë ka të bëjë me kandidaten Luljeta Ikonimi, e cila, nëpërmjet një *e-mail*-i që na ka dërguar, ka kërkuar të tërheq dosjen e aplikimit. “Për arsye objektive e kam të pamundur të jem në seancë, ndaj kërkoj tërheqjen e dosjes së aplikimit”. Pra, siç e kuptoj unë, zonja Luljeta Ikonimi Caraoshi tërhiqet nga gara.

Gjithashtu, kemi marrë edhe një *e-mail* zyrtar nga zonja Elena Papa, me të cilin na vë në dijeni se, fatkeqësisht, në datat 11 dhe 12 prill do të ndodhet në Budva në cilësinë e moderatores së një aktiviteti për të drejtat e njeriut të organizuar nga Këshilli i Europës. “Për rrjedhojë, do t’ju lutesha të më mundësoni një ditë dhe një orar tjetër dëgjese”. Ne kemi menduar që dëgjesa tjetër me zonjën Elena Papa në nënkomisionin e të drejtave të njeriut të realizohet ditën e hënë në orën 12:00.

Faleminderit!

Ervin Bushati – Meqenëse zonja nuk është prezente sot dhe paska një datë tjetër dëgjese, mund të njoftohet edhe zonja tjetër që të vijë të hënë?

Eglantina Gjermani – Për zonjën Luljeta Ikonomi e keni fjalën?

Ervin Bushati – Po.

Vasilika Hysi - Zonja Luljeta Ikonomi ka kërkuar tërheqjen e dosjes, por, në bazë të rregullave të Kuvendit, i kam kërkuar të drejtohet zyrtarisht në adresën e komisionit dhe *e-mail-i* ka ardhur në adresën zyrtare të komisionit.

Xhemal Qefalia – Për shkak të transparencës (zonja Hysi është vazhdimisht shumë konsekuente e kësaj procedure), i njoftoj edhe kolegët e tjerë, të cilët nuk janë të pranishëm. Në sallë ndodhet vetëm e para, kurse të tjerët do të ftohen sipas radhës, sepse janë jashtë.

Të nderuar anëtarë të nënkomisionit, mendoj që koha në dispozicion të secilit kandidat për t’u prezantuar të jetë 3 minuta, pasi ne i kemi CV-të përpara. Mendoni se është kohë e mjaftueshme?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, secili nga kandidatët ka të drejtë që brenda 5 minutave të paraqesë CV-në e tij dhe mundësitë që ka për të konkurruar në rastin konkret.

Fjalën e ka zonja Mandro.

Arta Mandro - Përshëndetje të gjithëve!

Shumë faleminderit për ftesën në këtë dëgjese publike! Ndihem shumë e nderuar.

Unë quhem Arta Mandro. Aktualisht jam pedagoge në detyrë në Shkollën e Magjistraturës. Për një periudhë të gjatë kohe kam drejtuar në këtë institucion Programin e Formimit Vazhdues të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Jam diplomuar si juriste në vitin 1986. Një pjesë të mirë të karrierës sime ia kam dedikuar mësimdhënies si pedagoge në Fakultetin e Drejtësisë, mandej kam pasur një eksperiencë pak më shumë se 2-vjeçare si zëvendësministre e Drejtësisë dhe aktualisht jam pedagoge në Shkollën e Magjistraturës.

Veprimtaria ime pedagogjike është ndërthurur ngushtësisht me spektrin e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut. Për këtë arsye unë kam pasur një bashkëpunim të ngushtë me organizata jofitimprurëse, të cilat kanë qenë të spikatura në veprimtarinë e tyre.

Mendoj që kontributin tim e kam dhënë në disa drejtime. Së pari, në veprimtarinë kërkimore-shkencore. Udhëtimi i realizimit të lirive dhe të drejtave themelore të njeriut është një udhëtim i gjatë, delikat, ku secili nuk është i njohur dhe i ditur mjaftueshëm. Kështu që, një pjesë të mirë të kohës ia kam dedikuar pasurimit të njohurive të mia dhe më pas gjenerimit të këtyre njohurive, përfshirë këtu jo vetëm brezat e rinj të juristëve, por edhe gjyqtarët dhe prokurorët, përfshirë ata në programin e formimit fillestar dhe në programin e formimit vazhdues. Kam pasur bashkëpunim të ngushtë me strukturat e Policisë së Shtetit, ku si trajnuese kam shërbyer në rritjen e performancës së tyre edhe në drejtim të çështjeve që kanë të bëjnë me momentet delikate, pikërisht me momentet e privimit të lirisë.

Unë mendoj se, përveç aspekteve të punës kërkimore shkencore dhe asaj si trajnuese, me modesti dua të them se kam disa aftësi komunikuese. Unë mendoj se CPT-ja është një komitet, ku përveç njohurive, kërkohen edhe shumë aftësi, ku personi, i cili intervistohet dhe është në një botë të një privimi të të drejtave të tij dhe lirive themelore, në mënyrë që CPT-ja të realizojë detyrat e veta dhe të ketë një lloj komunikimi miqësor dhe të besueshëm. Unë, në fakt, jam anëtare në detyrë e CPT-së dhe detyra ime vazhdon deri në fund të këtij viti.

Unë e pranova me shumë kënaqësi ftesën dhe mendova se kjo transparencë dhe këto seanca të bëra kaq publikisht ia rrisin reputacionin shtetit shqiptar në organizata të tilla me kaq impakt dhe kaq influencë, të cilat janë shumë të rëndësishme dhe kaq të brishta në çështje siç janë liritë dhe të drejtave themelore të njeriut. Kështu që unë mendoj se në 4 vjet eksperiencë jam përpjekur që ta evidentoj veten time në CPT (Komitetin Kundër Torturës) edhe me qëndrime modeste, sepse, sado të ditur të jemi në fushën e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut në vendet e privimit të lirisë, më lejoni t'ju them se CPT-ja përbëhet nga ekspertë të nivelit shumë të lartë, të cilët kanë përvojë të gjatë aty dhe CPT-ja funksionon si një organizëm i gjallë, ku ata që janë të rinj, jo në moshë, por në përvojën e tyre në raport me CPT-në, mentorohen nga ekspertët senjër. Unë kam pasur mundësinë që të realizoj 4 vizita me CPT-në dhe kam vënë re se kjo organizatë ka disa cilësi të jashtëzakonshme, në kuptimin e kualiteteve të ekspertëve. Prandaj sot ndihem shumë e nderuar që kandidoj, ndonëse për disa si pedagoge e tyre, me të tjerë kandidatë, që janë po kaq elitare, të rritur, të performuar dhe të formuar, pse ta mohoj, edhe më ngushtësisht, sepse punoj në terren me sfidat që ka një vend i caktuar, siç është Shqipëria, që është kaq delikate, ndonjëherë e pakuptueshme midis standardeve në fuqi, mënyrës sesi ata qëndrojnë dhe zbatimit të tyre. Unë mendoj që kam disa cilësi të forta, të cilat

janë të lidhura me njohuritë e mia për të drejtat dhe liritë themelore të grupeve vulnerabël. Mund ta quaj veten time njohëse të mirë e të drejtave të fëmijëve, kjo edhe për shkak të punës sime në Shkollën e Magjistraturës, të kontakteve të jashtëzakonshme që kam me jurisprudencën e gjykatave shqiptare të të gjitha niveleve, të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut...

Xhemal Qefalia –Ju lutem, mundohuni ta përmbyllni fjalën tuaj!

Arta Mandro – ...dhe njohurive që kam për të drejtat e grupeve të tjera vulnerabël, që bëhen edhe më vulnerabël në situata të tilla, siç janë të drejtat e grave, të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe të drejtat e personave të komuniteteve etnike rom, egjiptianë dhe LGBT-ve.

Nëse mundem të flas pak në Anglisht... më lejoni të prezantohem. Unë jam Andra Marto, anëtare aktuale e Shqipërisë pranë Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Degradues, pedagoge në Fakultetin Juridik që prej vitit 1986, aktualisht punoj në Shkollën e Magjistraturës, prandaj mendoj se kam të gjitha aftësitë , duke u nisur dhe nga eksperiencia profesionale dhe praktike për të qenë anëtare e CPT (Komitetit për Parandalimin e Torturës) dhe anëtarja e ardhshme e tij. E kuptoj që është një proces shumë sfidues për të qenë anëtare e këtij komiteti, sepse përballesh me çështje shumë delikate, që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut. Para pak ditësh kam qenë në Greqi, në disa qendra të ndryshme dhe e kam treguar veten si personi i aftë për të vazhduar më tej, dhe këtu dua të theksoj se CPT është një proces, i cili kërkon shumë përvojë dhe unë mendoj se jam në fazën e duhur dhe e maturuar për të dhënë atë çfarë kam fituar gjatë kësaj kohe.

Xhemal Qefalia – Faleminderit, zonja Mandro!

Kalojmë te pyetjet.

Kush ka pyetje për zonjën Mandro? Po, zoti Bushati.

Ervin Bushati- Faleminderit!

Ervin Bushati, deputet dhe drejtues i delegacionit parlamentar të Këshillit të Europës.

Në fakt, vij nga një eksperiencë e mirë, ku mbyllëm me sukses edhe zgjedhjen e gjyqtarit në Strasburg dhe jemi përpjekur që të kemi një procedurë sa më të hapur, sa më transparente, sa më të gjerë dhe sa më gjithëpërfshirëse që në një institucion, ku ne jemi me të drejta të barabarta, të prezantohemi denjësisht dhe, duke parë edhe nga cilësia, edhe nga përgjigjja që kemi, mendoj se ia kemi arritur.

Unë kam dy pyetje të shkurtra.

Së pari, në eksperiencën tuaj 4-vjeçare, në çfarë rezolutash ose punimesh keni marrë pjesë dhe cilat janë qëndrimet tuaja kryesore?

Së dyti, ku mendoni se po cenohen më shumë këto të drejta, çfarë mendimi keni. Nëse neve do të na duhet të japim atje qëndrimin tonë, i cili është universal, duhet të jetë i barabartë, duhet të jetë i respektuar dhe i vlerësuar njësoj nga vendet e tjera, ku ne jemi me të drejta të barabarta, si Anglia, Franca e të tjerë, duke parë edhe se si po shkojnë zhvillimet qoftë në trajtimin e minoriteteve, qoftë të zonave të okupuara apo edhe të gazetarëve, duke marrë parasysh edhe vende që janë anëtare, ndonëse sot në diskutim, si: Rusia, Turqia e të tjerë. Këto janë dy pyetjet e mia.

Faleminderit!

Arta Mandro – Faleminderit, zoti Bushati, për pyetjet!

Ervin Bushati – Në qoftë se doni, mund ta jepni përgjigjen në anglisht, nuk ka problem.

Arta Mandro – *Faleminderit për pyetjen. I vlerësoj të dyja pyetjet sepse janë të lidhura me njëra tjetrën. Së pari, ju doni të dini eksperiencën time si anëtare e CPT-së dhe cili ka qenë roli im aty. Kam qenë pjesë e katër misionëve të CPT, siç e shpjegova dhe më parë CPT është një organizëm, i cili përpiket të përgatisë kandidatë të rinj, të sapo ardhur, në vendet që mund të themi nuk janë aq problematike, duke bërë të mundur anëtarësimin e tyre dhe duke i njohur me anëtarë të tjerë të shquar dhe me shumë eksperiencë në CPT. Unë kam qenë me fat sepse vizita ime e parë ka qenë në Lihtenshtajn, vizita e dytë në Slloveni, e treta në Republikën Çeke dhe vizita e katërt në Greqi. Në këtë mënyrë unë kam mundur të shoh në këto shtete se cilat janë ndryshimet në standarde, jo vetëm në kuadrin ligjor, por dhe porsa i përket aplikimit të kuadrit ligjor, mënyra se si stafi në këto vende u përgjigjet nevojave të të drejtave të njeriut të atyre që janë brenda institucionit.*

Kontributi im i parë ka qënë në përgatitjen e raporteve dhe raportet e CPT-së bazohen në konspektet që përgatit çdo anëtar i CPT-së. Jam e kënaqur kur them se kontributi im me konspektin tim të parë ka qënë...më falni për mungesën e modestisë...shumë i vlerësuar dhe ka shërbyer si bazë për sekretariatit në përgatitjen e raportit final. Pra, kontributi im kryesor ka qënë në këtë drejtim, përgatitja e konspekteve dhe përdorimi i këtyre kontributeve në përgatitjen e dokumentave finalë, që do të thotë dokumentave në përgatitjen e të cilave merr pjesë gjithë komisioni. Është një dokument ku çdo njohuri praktike duhet të jetë e lidhur ngushtë me aftësitë akademike të të shkruarit për shkak të terminologjisë.

Kontributi im i dytë: menjëherë në vitin e dytë kam qënë pjesë e grupit të CPT-së për përgatitjen e instrumentave të ankesave, sipas standardeve të CPT, për ta përdorur atë si një mjet për anëtarët e CPT-së, por edhe për shtetet anëtare. Kjo sepse njerëzit në këto institucione në

përgjithësi keqkuptojnë kuptimin e një kërkesë me ankesën, sepse instrumenti i ankesës nuk ekziston në çdo vend, pra unë kam qenë pjesë këtij dokumenti. Në lidhje me kontributin tuaj si anëtar i Asamblesë Parlamentare, mendoj se ka shumë informacion në raportet e përgatitura nga CPT-ja, si dhe nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, e cila do ti përdorë shumë këto raporte të CPT-së, si informacion për shkeljen e të drejtave të njeriut në vende të ndryshme. Kjo padyshim është një mundësi për tu përdorur, në mënyrë që anëtarët e Asamblesë Parlamentare të zhvillojnë më tej çështjet themelore të të drejtave të njeriut.

Xhemal Qefalia – Jeni i qartë zoti Bushati? Në rregull.

Urdhëroni, zonja Gjermani!

Eglantina Gjermani - Faleminderit, zonja Mandro, për prezantimin dhe për punë e bërë për 4 vjet!

Duke qenë se ju listuat vendet që keni monitoruar dhe keni shkruar raporte, dua t'ju pyes nëse në këto vende që keni vizituar ka pasur shqiptarë, të cilët jetojnë atje dhe janë në kushtet e privimit të lirisë, meqenëse dëgjova se keni qenë edhe në Greqi. Besoj se është një çështje ndjeshme pjesa e të drejtave të njeriut dhe mënyrat se si disa shqiptarë janë trajtuar atje. A keni vënë re raste të tilla? Si janë pasqyruar ato në raportet që ju keni bërë, pra si mund të adresohen më tej pas raportimit që ju keni bërë?

Faleminderit!

Xhemal Qefalia – Faleminderit, zonja Gjermani!

Është një pyetje me shumë vend, por mua më vjen shumë keq që nuk mund të përgjigjem për atë, sepse anëtarët e CPT-së e kanë shumë të fortë detyrimin për të qenë konfidencial. Raporti nuk është përgatitur ende, sepse ne sapo e kemi përfunduar vizitën. Pas përgatitje së këtij raporti, ai do të bëhet publik kur shteti shqiptar të japë lejen e tij. Unë e kam të ndaluar, për shkak të nënshkrimit të deklaratës së konfidencialitetit me CPT-në, që të shprehem në një tryezë të tillë. Është e vërtetë që unë kam intervistuar shumë shqiptarë, sikurse është e vërtetë që në burgjet e Greqisë popullsia shqiptare, dhe kjo nuk është konfidenciale, përbën 30% të të burgosurve. Kjo arsyeja që CPT-ja mendoj se unë isha një aset për të, duke më përfshirë në këtë vizitë. Më lejoni t'ju them se vizita të tilla, kur keni shtetas të shtetit nga vini, bëhen më delikate edhe më të vështira dhe ndonjëherë mund të ketë edhe aspekte emocionale, për shkak situatave përballë të cilave vendosesh për shkak të një konfidencialiteti edhe më të madh që krijohet me personin që je duke intervistuar. Vetëm për shkak të të qenit anëtar i CPT-së personalisht jam përpjekur shumë... Në fakt, unë isha në një vizitë që drejtohej nga kryetari i CPT-së. Ishte një vlerësim shumë i madh për mua që të isha në të njëjtën vizitë

me të dhe të ndaja çështje vërtet problematike, të cilat lidhen edhe me popullsinë shqiptare në ato vende.

Faleminderit për pyetjet!

Xhemal Qefalia – Faleminderit!

Sajmir Vishaj– Unë ndihem i privilegjuar, së pari, që jam një nga studentët tuaj. Jemi një moment delikat në qendrat e paraburgimit apo të burgimit sot në Shqipëri, pas shfuqizimit të një dispozite, ku kishim lirinë e të burgosurve për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore të tyre. Aktualisht kemi disa vdekje natyrale, për shkak të sëmundjeve patologjike, por familjarët nuk i marrin dot më parë ata, por i marrin trupat pas vdekjes. A konstatojnë CPT-ja, ku ju bëni pjesë, ndonjë rekomandim në këtë lloj dispozite që është shfuqizuar, ose a keni ndonjë monitorim ose rekomandim në lidhje me këto vdekje? A është normale edhe me këtë dispozitë të hequr?

Xhemal Qefalia – Zonja Mandro, para se të jepni përgjigje, do të doja të ishit më konciz në dhënien e përgjigjeve, që t'ju lëmë kohë edhe të tjerëve për të bërë pyetje.

Arta Mandro – Unë jam anëtarë e CPT-së, thuhet “*in respect of Albania*”, por, pasi marr detyrën, unë nuk punoj më për Shqipërinë, kështu që delegacionet e CPT-së përbëhen nga anëtarë të tjerë të shteteve të tjera anëtare. Në dijeninë time, por kjo është publike edhe nga raportet, nuk më rezulton një thellim lidhur me shqetësimin tuaj.

Xhemal Qefalia – Faleminderit!

Zonja Bushka.

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Qefalia!

Përgëzoj profesoreshë Artën dhe të gjithë kandidatët, që i janë përgjigjur thirrjes për këtë mision shumë të rëndësishëm, i cili tashmë ka një emër të mirë në arenën ndërkombëtare për sa i përket Shqipërisë.

Siç e tha edhe kolegu Bushati, bërja e këtij procesi kaq transparent, duke ndjekur të gjitha rekomandimet e Këshillit të Europës dhe Asamblesë Parlamentare, bën të mundur që jo vetëm të përzgjidhen kandidatët më të mirë dhe të dalë në pah kjo punë, por edhe të njihet për publikun se çfarë është ky mekanizëm, sepse në Shqipëri shumë pak arrijnë të kuptojnë se çfarë është CPT-ja, çfarë është Komisioni i Venecias, çfarë CEPEJ-i, që është institucioni për standardet e gjyqësorisë. Nëse këto njihen nga qytetarët dhe nëse kuptohet që shteti shqiptar funksionon në përputhje me standardet që nxjerrin këto institucione, rritet edhe besimi në të gjithë veprimtarinë që bëjnë. E bëra këtë hyrje, sepse dua t'ju pyes, profesoreshë, për një çështje që unë e çmoj shumë të rëndësishme. Të gjithë përfaqësuesit tanë në këta organizma ndërkombëtarë kërkohet të kenë një rol proaktiv. Vërtet ju zgjidheni “*in respect of Albania*”,

pra jeni përfaqësues i Shqipërisë, ndërkohë që punoni në atë institucion dhe mbani lart standardet dhe qëllimet e CPT-së në kuadrin e vendeve që janë anëtare të saj. Roli proaktiv ka të bëjë pikërisht me faktin që ju atje, përveçse punoni për vende të caktuara gjatë monitorimeve dhe bëni raportet tuaja, përvetësoni dhe bëni tuajat standardet më të mira për sa u takon të drejtave të njeriut, të cilët vuajnë dënime qofshin në situata kur e kanë marrë një dënim të formës së prerë apo në paraburgim, si dhe merrni standardet më të mira për sa i takon mbrojtjes nga mënyrat më çnjerëzore të torturës apo të degradimit human. Të gjitha këto, që ju tashmë i keni si kapitale, si mund t'i bëni të ndërveprojnë, në mënyrë që institucionet shqiptare, të cilat punojnë, të kenë këto standarde të vëna në dispozicion jo nga ju vetë, por si përfaqësuese e CPT-së? Çfarë mekanizash përdorin shtetet e tjera, që përfaqësuesit e CPT-së, të gjitha ato standarde që i miratojnë njëzëri dhe kërkojnë të zbatohen nga shtetet, të bëhen pjesë e të drejtës së brendshme? Kam edhe një fjali të fundit, se e zgjata pak. Për shembull, unë, kolegu Bushati dhe kolegja Gjermani miratojmë rezoluta si anëtarë të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës, por vijmë në Shqipëri dhe përpiqemi që, në të drejtën tonë të brendshme, t'i futim ato standarde. Në këtë kuadër do të doja të dija nëse ka ndodhur diçka e tillë deri sot në fushën tuaj? Si mund të jetë kjo punë në të ardhmen?

Faleminderit!

Arta Mandro - Faleminderit për pyetjen!

Unë u përgjigja me kënaqësi thirrjes, ndonëse hezitova pak pasi jam në vazhdim të një mandati dhe thashë: jam e duhura, e legjitimuar që të pranoj jo thirrjen, por edhe pjesëmarrjen në këtë intervistë. Është e vërtetë që të punosh pranë CPT-së pasurohesh shumë. Unë i jam mirënjohëse kësaj organizate, pavarësisht faktit nëse do të vazhdoj të jem pjesë e saj, pasi këta 4 vjet kanë qenë vite që më kanë transformuar njohuritë e mia në shumë drejtime.

Unë e kuptoj pyetjen tuaj që lidhet me rolin proaktiv dhe që nxitet më së shumti nga detyra juaj si pjesë e Kuvendit, e legjislativit. Nga analiza që i bëj legjislacionit shqiptar, akteve ligjore dhe nënligjore dua të them se ka pjesë të legjislacionit që janë të ndërtuara shumë mirë, në përputhje me standardet ndërkombëtare, por rreziku i legjislacionit shqiptar është te normat neutrale. Çfarë do të thotë norma neutrale? Norma neutrale është norma që i trajton të gjithë të barabartë, pa bërë diferencën, pa ndërmarrë aksionin pozitiv të detyrueshëm dhe të parashikuar në ligj. Kjo është e para.

E dyta, në vendet e suksesit punohet shumë me autoritetet, me stafe, me ata që shërbejnë, sepse CPT-ja sikurse OJF-të, sikurse mekanizmat *National Prevention Mechanism* janë institucione që sado t'i kenë radarët në funksionalitet të plotë, i kanë ata të përkohshëm

dhe evidencat, manipulimet me provat, regjistrat e pasaktë, moszbatimi i legjislacionit gjithmonë mund të çojë në fshehjen e një keqtrajtimi. Mendoj se trajnimet e vazhdueshme dhe dokumentet e bëra publikë janë të rëndësishëm, pse jo?

Në mbledhjen e fundit të CPT-së kemi bërë një *brainstorming*, se si vetë CPT-ja si organizatë nëpërmjet anëtarëve të saj duhet të bëhet më e dukshme në shtet. Më parë ka qenë qëndrimi pak si në hije, tani kemi menduar të ndryshojmë strategji. Pse? Në fund të fundit interesi i kësaj organizate nuk është thjesht të penalizojë shtetin, por të parandalojë dhe të përmirësojë shtetin. Jemi duke diskutuar mbi këto hapësira që mund të kenë anëtarët e CPT-së që influencojnë në shtetin nga ata vijnë dhe të bashkëpunojmë me organizatat si pjesë e këtij shteti, në mënyrë që standardet të mos mbeten në ligj apo në letër, por të bëhen të aplikueshme nga stafet.

Unë mendoj se trajnimi i vazhdueshëm, pambarim i stafeve përmes rasteve praktike, përmes shkuarjes në institucion, këtë dua të nënvizoj, sepse unë trajnoj gjyqtarë dhe prokurorë rregullisht, kam shumë frikë se disa prej tyre ndërkohë që japin vendime, nuk e kanë haberin se ku janë duke e çuar këtë të mitur, ku janë duke e çuar këtë grua, apo një person me aftësi të kufizuara. Pra, ka rëndësi bërja e trajnimeve atje, në vend. Unë mendoj se Shqipëria ka më shumë nevojë për *study visit*, *press practics*, por mendoj se ka shumë nevojë për *study visit* këtu, unë të shkoj atje në vend dhe të njoh përvojën më të mirë. Pra, të ketë lëvizje të të gjithë autoriteteve, në mënyrë që ato vetë ta bëjnë *brainstorming*. Vetëm në këtë mënyrë mendoj se standardet mund të bëhen të realizueshme. Sado ligje të bukura të mira, të sakta, të qarta të bëjmë, norma neutrale ka shumë rëndësi.

Xhemal Qefalia - Faleminderit, zonja Mandro!

Ka pyetje? Nuk ka.

Më lejoni të falënderoj zonjën Mandro për të gjithë rezymenë që paraqiti dhe përgjigjet e pyetjeve!

Ju uroj suksese!

Arta Mandro - Ishte shumë kënaqësi, një nder dhe privilegj për mua që e çmoj shumë.

U uroj sukses kandidatëve dhe juve në detyrën tuaj!

Xhemal Qefalia – Të paraqitet Aurel Boriçi.

Mirëdita zoti Boriçi!

Siç jeni njoftuar sot jeni paraqitur pranë komisionit dhe të ftuarve për pozicionin si përfaqësues i Shqipërisë në Organizatën Ndërkombëtare të CPT-së.

Rregullat e komunikimit në komision ne i kemi diskutuar për të gjithë kandidaturat. Kemi CV-në tuaj përpara. Ndërkohë ju keni të drejtë rreth 5 minuta për atë çfarë keni për t'u prezantuar anëtarëve të këtij nënkomisioni dhe të ftuarve të tjerë.

Në fazën e dytë do të kalojmë te pyetjet.

Fjala është për ju!

Aurel Boriçi- Mirëdita!

Jam përgjegjës i Marrëdhënieve me Publikun në Bashkinë e Tiranës prej 4 vjetësh e gjysmë. Arsyeja pse aplikova për këtë pozicion është se kam një përfshirje direkte në ndihmën e personave të mitur, të personave që kanë pasur nevojë për ndihmë sociale, shtresat e marginalizuara, që janë trajtuar nga institucioni ynë. Eksperienca ime në këtë institucion që nga vitit 2003 në fushën e gazetarisë dhe të çështjeve sociale, më ka bërë të besoj se jam një kandidat për këtë vend, që gjithsesi është i privilegjuar. Kemi pasur shumë raste të çështjeve sociale dhe të personave të marginalizuar, kur ne kemi marrë në dorë lehtësimin e fazës së personave të mitur. Në vitin 2017 dhe vitin e kaluar kemi pasur 35 raste të referimit nga Bashkia e Tiranës për Shërbimin e Provës, 16 prej tyre kanë qenë nga institucioni i vuajtjes së dënimit të të miturve në Kavajë. Ne i kemi marrë për t'i siguruar ata se do të kenë një vijueshmëri të jetës sociale, të formësimit të tyre, të ndihmës së tyre pas përfundimit të vuajtjes së dënimit. Kemi aplikuar në disa raste, si në rastin e të miturve ashtu dhe në rastin e grave që kanë përfunduar vuajtjen e dënimit me bonuse qiraje, strehë sociale ose paketa ushqimore deri në rastin e granteve për të krijuar biznes, në mënyrë që të lehtësojmë riintegrimin e tyre në shoqëri. Kemi pasur shumë procese ndërgjegjësuese, restauruese për personat që u është dashur të kryejnë orë në shërbim të komunitetit, Bashkia e Tiranës ka qenë si një urë lidhëse në këtë rast. Kemi një memorandum bashkëpunimi me Drejtorinë e Burgjeve aktualisht dhe jemi në një fazë avancimi dhe pothuajse finalizimi me Ministrinë e Drejtësisë për këtë çështje.

Siç e thashë më parë, gjatë viteve 2017 dhe 2018 kemi pasur 16 raste të ekzekutimit të dënimeve alternative. Bashkia e Tiranës është një aktore dhe një faktor shumë i fortë në këtë pjesë për të ndihmuar shtresat e marginalizuara ose njerëzit, të cilët përfundojnë kohën e tyre në institucionet e vuajtjes së dënimit për t'i riintegruar më pas në shoqëri. Ka, gjithashtu, trajtim nevojash më afatgjata, siç janë strehimi social ndërmjetësim për punësimin. Ne kemi shërbyer si urë lidhëse për të dërguar kërkesat e tyre ose për t'i përshtatur nëpër fasoneri ose nëpër kurse, në mënyrë që ata të krijojnë një pavarësi pas përfundimit të dënimit.

Gjithashtu, pjesë e ndihmës sonë është edhe këshillimi ligjor dhe psikologjik, në mënyrë që ata të mos ndjehen të diferencuar.

Xhemal Qefalia - Faleminderit!

Urdhëroni, zonja Gjermeni!

Eglantina Gjermeni - Faleminderit!

Ju falënderoj për prezantimin dhe suksese!

Doja t'ju pyesja se cilat janë disa nga pikat tuaja të forta që mendoni se ju bëjnë kandidat të duhur për këtë pozicion.

Mund ta bëni përgjigjen në anglisht ose frëngjisht, cila është gjuha e huaj që zotëroni, që ta kemi më të lehtë të vlerësojmë!

Aurel Boriçi – *Një nga pikat e mia më të forta është gjuha Angleze, pasi unë kam studiuar për Gjuhë Angleze dhe e kam përfunduar atë me rezultate shumë të mira. Kam punuar për Deutche Ëelle, si redaktor dhe kryeredaktor për seksionin shqiptar. Po ashtu, një pikë tjetër e fortë e imja është se kam punuar si gazetar dhe kryeredaktor që nga viti 2003. Ajo çka bën diferencën ndërmjet meje dhe kandidatëve të tjerë është se, sipas mendimit tim, Shqipëria, në këtë pozicion ka nevojë të ketë një person që e kupton tjetrin pa folur. Nga inspektimet dhe takimet e CPT-së kuptohet se ka disa situata ku njerëzit vuajnë nga abuzimet psikologjike dhe fizike, dhe nuk ta thonë në mënyrë të drejtpërdrejtë gjatë inspektimeve. Pra, një nga pikat e mia më të forta është se duke qenë reporter mund ta dalloj dhe ta kuptoj situatën më mirë, e cila mund të ndryshojë nga një person tek tjetri.*

Xhemal Qefalia - Faleminderit!

Ervin Bushati - Faleminderit!

Në u përpoqëm të bëjmë një instrument sa më të hapur, sa më të gjerë dhe gjithëpërfshirës dhe më vjen mirë që kemi edhe një kandidat që vjen nga kjo fushë me këtë eksperiencë. Në momentin që zgjidhesh aty, detyra ka të bëjë me të drejtat e njeriut në të gjithë Europën, domethënë përfaqëson Shqipërinë, por nuk je më për Shqipërinë. Vlejnë këto eksperiencia.

Dua të di shkurt se çfarë mendimi keni për situata që po diskutohen sot në vendet me të cilat ne kemi marrëdhënie diplomatike bilaterale, por Këshilli i Europës, në radhë të parë ka të drejtat e njeriut, demokracinë dhe synimin e ligjit.

Si mendoni ju për trajtimin e qytetarëve, të gazetarëve, meqë vetë jeni gazetarë në vende si Ukraina, Rusia apo Gjeorgjia, pra vende që kanë konflikte apo që mund të kenë problematika të njohura edhe nga Këshilli i Europës.

Ju lutem, në anglisht!

Aurel Boriçi – Gjatë trajnimeve të mia vitet e fundit, zakonisht ndjek një herë në vit këto trajnime jashtë vendit për çështje sociale, të medias dhe lirisë. Në vizitën time të fundit kam qenë në Pekin dhe Kina nuk është një shembull i mirë për median, lirinë dhe qeverisje të mirë, kur bëhet fjalë për përgjegjësi sociale.

Atje kam diskutuar me aktivistë politikë dhe gazetarë ukrainas dhe ata vuajnë kryesisht shtypjen nga partitë politike, duke devijuar fokusin e lajmeve të tyre, sidomos kur raportojnë kryesisht për debatet politike dhe çështjet politike sesa kur fokusohen në çështje të përgjithshme dhe sociale të cilat ndryshojnë nga një rajon në tjetrin. Pra, siç më pyetët më parë për situatën në Ukrainë, atje ekziston një problem i madh, pasi ka disa zona të cilat kontrollohen nga separatistët rusë, gjë që i bën këto zona pothuajse të padepërtueshme nga gazetarët vendas dhe ato perëndimorë, që të shkojnë atje për të bërë një raportim të pavarur. Ka shumë raste abuzimi atje, veçanërisht me të burgosurit politikë, të cilët vuajnë përkatësinë e tyre politike. Ato vuajnë nga abuzimi fizik dhe psikologjik për shkak të këtij rajoni të ndarë.

Xhemal Qefalia - Faleminderit!

A ka pyetje të tjera?

Klotilda Bushka – Faleminderit që i jeni përgjigjur kësaj thirrje, pyetja ime ka të bëjë, ju si gazetar keni bërë raportime të herë pas hershme, dua t'ju pyes CPT-në e keni njohur gjatë punës suaj si gazetar? Çfarë ju shtyu të aplikoni në këtë garë?

Aurel Boriçi - Gjatë punës sime në Dojçe Vele kam rënë fillimisht në kontakt me CPT-në, me përfaqësues të tillë, sepse gjatë një reportazhi që ne bënim për Dojçe Velen në Bon (unë kam jetuar dhe punuar atje) na kanë referuar çështje të keqtrajtimit dhe presionit mbi njerëzit, të cilët mbaheshin në qendra grumbullimi për refugjatët. Qysh në kontaktin e parë që kam pasur me përfaqësues të CPT-së, jam joshur për të aplikuar në vende të tilla, por eksperiencia ime e vakët në atë kohë më bënte që të mos kisha muskujt e mjaftueshëm profesionalë që unë të synoja të bëja një tentativë të tillë. Me kalimin e viteve, me fitimin e eksperiencave të ndryshme, siç e thashë, unë jam në marrëdhënie pune që prej vitit 2003 në këtë lëmë, puna ime në bashkinë e Tiranës dhe kontaktet me shtresa të tilla, me gra të cilat përfundojnë vuajtjen e dënimit, me shtresa që preken nga projekte madhore sociale, siç janë projektet madhore të Bashkisë së Tiranës, ndihma që ne kemi dhënë karshi tyre, më ka bërë që të mendoj dhe të synoj këtë post, që për mua është shumë i privilegjuar. Mbase mund të them edhe se është shansi më i mirë i jetës sime, kështu që jam i përgatitur të luftoj shumë për ta arritur.

Xhemal Qefalia – Faleminderit, zoti Boriçi!

Nuk ka pyetje të tjera.

Atëherë ju urojmë suksese dhe ju falënderojmë!

Faleminderit, zoti Boriçi! Suksese!

Aurel Boriçi – Faleminderit!

Xhemal Qefalia – Ftojme kandidaturën e radhës, zonjën Brunilda Menella.

Mirdita, zonja Brunilda!

Brunilda Menella – Përshëndetje!

Xhemal Qefalia – Të nderuar kolegë,

Të nderuar të ftuar,

Ashtu siç e thamë edhe për kandidaturat e tjera, edhe zonja Brunilda ka aplikuar për kandidaturë për Shqipërinë në CPT.

Zonja Brunilda, koha për të shprehur arsyet për të cilat keni aplikuar, është rreth pesë minuta. Ndërkohë, ne kemi edhe CV-në tuaj. Kjo do të jetë pjesa e parë, ndërsa në pjesën e dytë do t'u përgjigjemi pyetjeve të deputetëve, të anëtarëve të nënkomisionit e të kolegëve të tjerë të ftuar.

Fjala për ju!

Brunilda Menella – Faleminderit!

Përshëndetje! Quhem Brunilda Menella!

Para disa ditësh, kur pashë vendin vakant, mendova të bëja aplikimin, me gjithë dokumentacionin përkatës që më kërkohet. Në fillim mendova në lidhje me kriteret, nëse i plotësoja ato. I kam parë shumë imtësisht. Ai që më krijoi arsyen që të aplikoj, ishte fakti se do të vlerësoheshin studentët që janë diplomuar jashtë Shqipërisë. Unë jam diplomuar jashtë Shqipërisë. Në Shqipëri jam kthyer në vitin 2011. Si brenda, ashtu edhe jashtë Shqipërisë, vendin tim e kam përfaqësuar denjësisht. Fakti se kam arritur rezultate shumë të larta në universitet, madje kam qenë studente ekselente. Jo vetëm në Shqipëri, por edhe e diplomuar jashtë me rezultate maksimale.

Pastaj ishin kriteret e të drejtave të njeriut. Kjo është një fushë, të cilën e kam pasur pasion që e vogël, duke krijuar ato grupet e vogla me moshatarët e mi, pastaj me studentët e më pas në profesionin tim si politologe. Kësisoj, kjo ishte arsyeja që më nxiti të aplikoj në këtë pozicion.

Lidhur me të drejtat e njeriut, kam shumë kurajë, sepse i respektoj. Dinjiteti, kurajoja dhe morali më bënë që të aplikoj për këtë pozicion.

Faleminderit!

Xhemal Qefalia– Faleminderit! Shumë koncize në rezymenë që paraqitet.

Kush ka pyetje?

Po, zoti Saimir, fjala për ju.

Sajmir Vishaj – Një pyetje kisha: ju vetë, personalisht, a keni shkelur apo konstatuar ndonjë IEVP, ndonjë stacion policie, ku vuajnë dënimin ose janë të paraburgosura gratë...

Brunilda Menella – Po, patjetër!

Xhemal Qefalia – Një sekondë, sa të mbarojë pyetjen!

Po, mund të përgjigjeni.

Brunilda Menella – Po, patjetër! Unë kam studiuar në Fakultetin e Sienës, në Itali, dhe në kohën kur zhvilloheshin praktikat në universitete, unë zgjidhja gjithmonë pjesën kur mund të shkohej në institutet kërkimore ose në burgje, kryesisht në atë të Firences, por edhe në qytete të tjera. Ishte një sferë që më tërhiqte, sepse doja të shikoja diçka ndryshe: një e drejtë e privuar, që në jetën e përditshme nuk arrin dot ta kuptosh e ta përjetosh.

Ato dy orë qëndrimi në ato institute, më shërbenin jo vetëm për të parë se si ishte situata, por edhe ta përjetoja gjatë atij qëndrimi të shkurtër.

Me kthimin tim në Tiranë, në Shqipëri kam punuar me formimin profesional në bashkinë e Tiranës, ku në disa raste më është dashur të bëja vizita enkas, sepse kemi pasur programe që, kur një i burgosur mbaron shërbimin e detyruar apo kryen dënimin. Unë jam marrë kryesisht me faktin se duhet ta integroja në shoqëri.

Kësisoj, disa herë jam përballur me këtë.

Xhemal Qefalia – Faleminderit!

Zoti Çyrbja.

Jurgis Çyrbja – Faleminderit, kryetar!

Si i keni vlerësuar raportet e CPT-së për Shqipërinë, nëse keni një përgjigje, ju lutem?
Në anglisht, nëse mundesh!

Faleminderit!

Xhemal Qefalia – Pyetjen e more. Besoj se e ke të qartë.

Brunilda Menella – Po.

Xhemal Qefalia – A mund të na përgjigjesh në anglisht ose në frëngjisht?

Brunilda Menella – *Unë do të përgjigjem në Anglisht,*

Në fakt procesi i vlerësimit po rrit situatën, sepse për momentin ne nuk mund të vendosim, ose unë nuk mund të them saktësisht si është situata sepse unë nuk jam pjesë e CPT-së, por situata është duke vazhduar dhe duke rritur procesin e çdo mekanizmi të..

Xhemal Qefalia – Faleminderit!

Pyetje tjetër? Zonja Gjermani.

Eglantina Gjermani – Faleminderit!

Çfarë vlere të shtuar do t'i jepni ju këtij pozicioni, në momentin që mund të zgjidheni në këtë pozicion, dhe çfarë kontributi konkret mendoni se mund të jepni?

Faleminderit!

Brunilda Menella – *Kur erdha këtu unë jam shprehur që kam studiuar jashtë, ndërkohë që disa këtu që kanë studjuar në Shqipëri duhet ta përkthejnë ligjin me përkthyes, ose të marrin ekspertë të jashtëm, unë vij nga një universitet ndërkombëtar, kam qenë në disa vende evropiane, edhe pse kam lindur në Shqipëri ndjehem pjesë e këtyre vendeve evropiane, kam marrë kulturë tjetër dhe kam një mënyrë tjetër të të menduarit. Kontributi im do të jetë së pari për shtetin, ju thashë që unë dua të ndryshoj opinionin që vendet e tjera kanë për vendin tim në lidhje me torturat dhe të drejtat e njeriut.. më falni për emocionet..*

Xhemal Qefalia - Faleminderit!

Eglantina Gjermani – Kam diçka për të thënë. Unë i kuptoj emocionet, se jam vetë tip emotiv. E vlerësoj këtë që the. Të studiosh jashtë është vërtet një mundësi e shkëlqyer dhe një vlerë, por kjo nuk do të thotë se ky është aseti më i madh... Duke respektuar të gjithë ata që kanë studiuar dhe punuar këtu dhe janë ekspertë shumë të mirë... Ky është thjesht...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më fal! Ta mbaroj!

Ky është një sugjerim edhe për karrierën tënde të ardhshme. Mbase pa dashje, por mund të ofendosh të tjerë.

Xhemal Qefalia - Faleminderit!

Fjala për ju.

Brunilda Menella – Në fakt, e theksova pjesën e studimit jashtë, sepse për pyetjen që m'u bë pak më parë, shtetet pjesë të komitetit apo Këshillit të Europës, i kam prekur nga afër. Kjo më bën të jem pak më afër legjislacionit. Nuk ka të bëjë me “unë kam studiuar jashtë dhe jam më e mira”...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ky është mendimi im. Gjithmonë kam ecur me parimin se të studiuarit në një vend anëtar të BE-së prek më nga afër pjesën e komiteteve apo...

Xhemal Qefalia – Faleminderit!

Po, zoti Bushati...

Ervin Bushati – Kam diçka të shkurtër.

Eksperienca e fundit (ndoshta e kam gabim) është në vitet 2015-2017. Nga viti 2017 e këtej, ku punoni?

Ndoshta mungon ndonjë faqe, nuk e di...

Xhemal Qefalia – Mund t'i përgjigjeni pyetjes konkrete.

Brunilda Menella – Pas përfundimit të marrëdhënieve të punës në Bashkinë e Tiranës, punoj në Komisionin e Mbrojtjes nga Diskriminimi. Ekzaktësisht, jam specialiste e marrëdhënieve me jashtë.

Xhemal Qefalia – A është shkruar në CV-në tuaj kjo?

Brunilda Menella – Në gjuhën angleze është shkruar, ndërsa në gjuhën shqipe jo. Ju kërkoj ndjesë! Madje, kam komunikuar...

Xhemal Qefalia– Faleminderit!

Ju lutem, prezantohuni!

Ardita Kolmarku - Përshëndetje! Unë quhem Ardita dhe vij nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit.

Pyetja ime lidhet jo vetëm me faktin që ju jeni keni ardhur tashmë dhe i keni mbaruar studimet në një vend fqinj si Italia, por edhe se jeni pjesë e Komisionit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Në këto kushte, ju e dini tashmë që Italia po kalon një reformim në institucionet e posaçme mjekësore, që nga viti 2015.

Dua të di mendim tuaj për këta shtetas, që po ekzekutojnë masën e mjekimit të detyruar në vendin tonë. Ata tashmë ndodhen në sistemin e burgjeve, nëse jeni në dijeni. Desha një mendim, duke qenë se kjo lidhet edhe me standardet CPT-SË.

Brunilda Menella – Kjo ka të bëjë me diskriminimin, që ne e hasim çdo ditë në punë. Institucioni ku punoj ka dhënë disa rekomandime drejtuar Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Shëndetësisë. Aktualisht, ne nuk kemi marrë një përgjigje. Madje e kemi ngritur edhe në komisione këtë çështje, që ky rekomandim duhet të zbatohet patjetër. Përgjigjja me shkresë zyrtare në disa raste ka ardhur që do të krijohet një institucion i posaçëm, ku ndërtimi i spitalit të jetë kryesisht në qytetet që kanë numrin më të lartë të të prekurve, për shkak se nuk ka kapacitete të mjaftueshme për kurimin e tyre, por edhe për mbajtjen në burgjet e vendit.

Ardita Kolmarku – Duke qenë se përgjigjja nuk ishte shumë ezauruese, përveç standardeve, që i njohim shumë mirë, dua të di mendimin tuaj personal. A është e drejtë vendosja aktuale e këtyre shtetasve? Si e shihni ju këtë, si një person i cili ka kandisur tashmë për një post, siç është vendi vakant për CPT-në?

Brunilda Menella – Aktualisht, nuk e shikoj të përshtatshme, sepse duhet të jenë në institucionet që sapo ju përmenda, duhet të jenë jashtë burgjeve.

Xhemal Qefalia – Faleminderit! Ka pyetje tjetër?

Brunilda Menella – Kam qenë prezente...

Xhemal Qefalia – A ka pyetje të tjera? Nëse nuk ka pyetje të tjera, zonja Brunilda, ju urojmë suksese!

Ftojme zonjën Drita Avdyli.

Mirëdita, zonja Drita!

Faleminderit që i jeni përgjigjur ftesës!

Siç jeni njoftuar, të gjithë kandidatët janë ftuar këtu për të treguar se cilat janë arsytet që kandidojnë për të përfaqësuar Shqipërinë në CPT.

Koha do të jetë jo më shumë se 5 minuta, pasi ne e disponojmë CV-në tuaj. Kjo është pjesa e parë e paraqitjes. Te pjesa e dytë do të fokusohemi te pyetjet që kanë kolegët dhe të ftuarit e tjerë. Këto janë rregullat.

Kam edhe diçka të tjetër. Për një ose dy pyetje do t'ju lutesha që përgjigjja të ishte në frëngjisht ose anglisht.

Faleminderit!

Fjala për ju.

Drita Avdyli – Faleminderit!

Të nderuar anëtarë të komisionit,

Ndihem e privilegjuar që jam këtu sot, sepse pas meje ndodhen edhe studentët e mi, të cilët janë pjesë e praktikës apo e dëgjësës sime në këtë seancë!

Unë jam Drita Avdyli. Kam mbaruar Fakultetin Ekonomik. I kam ngjitur shkallët e karrierës sime nga viti '87 e deri sot.

Kam shprehur dëshirën të jem pjesë e këtij procesi rekrutimi, sepse kam qenë pjesë e raporteve periodike të ACT-së, kur kam qenë drejtoreshë në Drejtorinë për Shtetësinë dhe Refugjatët. Kam qenë pjesë e vizitave në burgun e Guantanamo në Kubë, i cili u mbyll, sepse supozohej që ishin shkelur të drejtat e... Meqenëse Shqipëria kishte ratifikuar Konventën e Refugjatëve, ne i pritëm ata persona. Kam qenë pjesë e vizitave atje dhe e shtetit shqiptar, që priti 7 persona, për të cilët pretendohesh se u ishin shkelur të drejtat dhe u ishin bërë tortura.

Duke qenë se kam qenë edhe koordinatore e Ballkanit për migracionin, refugjatët dhe njësinë antitrafik, aplikova dhe meqenëse jam këtu dëshiroj t'u përgjigjem pyetjeve të sotme.

Xhemal Qefalia – Ju falënderoj, sepse ishit shumë koncize në rezyme!

Fjala për kolegët.

Atëherë, po e bëj unë i pari pyetjen. Duke qenë se CPT-ja shpeshherë ka qenë kritike edhe ndaj Shqipërisë, cili është opinioni juaj: kjo ka ardhur si rezultat i mungesës së kuadrit ligjor apo papërgjegjshmërisë së zbatimit nga ana e institucioneve ligjzbatuese?

(Diskutime pa mikrofon.)

Ju lutem, nëse nuk keni asnjë përgjigje, mund ta anashkalojmë pyetjen.

Drita Avdyli - Unë preferoj të përgjigjem në gjuhën shqipe, si gjuhë zyrtare. Më pas ndoshta mund të përgjigjem në gjuhën angleze.

Xhemal Qefalia – Është në zgjedhjen tuaj.

Drita Avdyli – Është e vërtetë se në vizitat periodike në komitet janë bërë vërejtje, por që kanë ardhur duke u përmirësuar. Unë mendoj se kjo ka ndodhur as për arsyen e parë dhe as për arsyen e dytë, por duke qenë se kemi ardhur nga një sistem totalitar edhe konventat i kemi ratifikuar më vonë në parlament. Pra, nga viti 1990 e këtej ne kemi qenë pjesë e këtyre ratifikimeve të konventave dhe çdo vit janë përmirësuar kushtet dhe kuadri ligjor, ku prezupozohet se janë shkelur këto të drejta.

Xhemal Qefalia – Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Bushati. Më pas e ka zonja Gjermani.

Ervin Bushati - *Shqipëria është anëtare me të drejta të plota e Këshillit të Evropës, që përfaqësohet nga 47 vende dhe ne përpiqemi të jemi sa më dinjitozë në përfaqësimin e vendit tonë, duke përdorur një procedurë të hapur dhe duke ftuar këdo për të marrë pjesë në konkurs. Çdo gjë ka të bëjë me standartet europiane të vendosura në shtete të ndryshme, pra cili është opinioni juaj për shtete të ndryshme që janë anëtare të Këshillit të Evropës por të cilat nuk respektojnë parimet bazë mbi të cilat është themeluar Këshilli i Evropës para 70 vitesh, parime të cilat janë të drejtat e njeriut, shteti i së drejtës dhe demokracia. Faleminderit!*

Drita Avdyli – Sigurisht, të tria këto konventa, ku Shqipëria është pjesë e Këshillit të Evropës, janë pjesë të standardeve, të cilat duhet të përmirësohen gjithmonë te raportet periodike, më pas edhe në vizitat dhe raportet që do të publikohen nëpërmjet marrjes së pëlqimit të të dyja palëve.

Xhemal Qefalia – Faleminderit!

Po, zonja Gjermani.

Eglantina Gjermani – Faleminderit, për prezantimin dhe sukseset!

Pyetja imë është: cilat janë dy apo tri pikat më të forta që ju mendoni se do t'ju ndihmojnë për ta marrë këtë pozicion dhe për ta kryer atë me sukses? Këto lidhur edhe me begraundin apo përvojën tuaj, por, pa dyshim, që lidhen me këtë pozicion që keni aplikuar.

Faleminderit!

Drita Avdyli – Siç e thashë më lart unë kam mbaruar Fakultetin Ekonomik, por në vitet 2000 kam mbaruar edhe Fakultetin Juridik. Meqenëse kam qenë pjesë e vizitave dhe raporteve, për shkak të detyrës që kam bërë si komisionere për refugjatët, pika ime e fortë është se kam qenë pjesë e këtyre raportimeve dhe të raportimi i shtatë apo i tetë kam bërë edhe disa korrigjime. Unë mendoj se, duke qenë se jam anëtare apo pjesë e Komitetit të Mbrojtjes së Drejtave të Njeriut, kontributi im do të ishte maksimal.

Xhemal Qefalia – Faleminderit!

A ka pyetje të tjera? Nuk ka.

Atëherë, ju falënderoj dhe ju uroj suksese!

Gjithë të mirat!

Ftojme kandidaturën e fundit, zonjën Ndroqi.

Faleminderit, zonja Ndroqi, që i jeni përgjigjur ftesës për të aplikuar si kandidate për anëtare për të përfaqësuar Shqipërinë!

CV-në tuaj e kemi në dispozicion. Ju keni të drejtën tuaj për të folur rreth 5 minuta se cilat janë arsyet që ju kanë bërë të kandidoni. Më pas në pjesën e dytë do të vazhdojmë me pyetje –përgjigje, që do të kenë kolegët e mi dhe të ftuarit e tjerë. Do t'ju lutesha që për një ose dy pyetje, si ta gjykoni ju, të përgjigjeshit në anglisht ose në frëngjisht.

Fjala për ju.

Erinda Bllaca Ndroqi – Faleminderit për mundësinë!

Unë quhem Erinda Bllaca Ndroqi. Në qoftë se dëshironi unë mund ta prezantoj veten në gjuhën angleze.

Xhemal Qefalia – Si ta gjykoni ju.

Erinda Bllaca Ndroqi – *Formimi im është ligjor, kam studiuar në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë nga viti 1994-1997, kam punuar për shumë kohë si....*

Xhemal Qefalia – Më falni, që ju ndërpres!

CV-në tuaj ne e kemi në dispozicion, ndaj, ju lutem, na thoni arsyet dhe motivet që ju kanë bërë të aplikoni. Besoj se kjo do të ishte më me interes për dëgjuesit.

Erinda Bllaca Ndroqi – *Kam punuar si aktiviste për të drejtat e njeriut dhe profesioniste e ligjore për mëse 15 vjet dhe me torturat në mënyrë të veçantë duke filluar nga viti 2007, kur u ktheva nga studimet. Që atëherë kam pasur mundësinë të punoj me Monitorimin e Burgjeve, duke mbuluar të gjitha institucionet e privimit të lirisë, duke përfshirë policinë dhe mjediset e ndalimit dhe të paraburgimit, d.m.th burgjet, kam pasur mundësinë të hartoj raporte*

alternative në lidhje me situatën e të drejtave të njeriut dhe privimin e lirisë dhe ky është motivimi për aplikimin tim në këtë pozicion.

Jam e vetëdijshme për rëndësinë dhe ndjeshmërinë e veçantë të këtij pozicioni dhe rolin që luan CPT-ja për përmirësimin e situatës së mjediseve të paraburgimit dhe të trajtimit të të ndaluarve në vend. Shqipëria ka pasur mundësinë të vizitohet 13 herë nga ky komitet, i cili ka nxjerrë raporte ad hoc dhe periodike dhe pika më e fortë e vendit tim është se të gjitha raportet janë publikuar dhe janë në dispozicion të OJQ-ve, për të përfituar dhe ndjekur rekomandimet, përveç atij të fundit, i cili është ende në proces.. Pra ky është motivimi im ...kam punuar në këtë fushë dhe mendoj se unë e njoh se çfarë do të thotë të kem mundësinë të aplikoj për këtë pozicion të rëndësishëm.

Faleminderit shumë!

Xhemal Qefalia – Faleminderit!

Kalojmë te pyetjet. Fjalën e ka zoti Bushati

Ervin Bushati – *Për më shumë se 70 vjet Këshilli i Evropës ka qenë gur-themeli në botë për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, Demokracisë dhe Shtetit të së Drejtës. Ne jemi anëtarë të plotë të saj, kështu që s'ka asnjë justifikim për ne, duhet të jemi, të sillemi dhe të prezantohemi me dinjitet, duke vendosur standarde më të larta. Sepse kur je atje, nuk je thjesht anëtar i delegacionit shqiptar, por përfaqëson vlerat e shenjta të njerëzimit, Evropës, shtetit të së drejtës dhe demokracisë. Ndaj, kur të jesh atje, cili është mendimi juaj dhe cila do të ishte përgjigjja juaj ndaj disa situatave që ndodhin në vendet anëtare, Këshilli i Evropës ka 47 vende anëtare dhe ato vetë ndonjëherë janë në shkelje të të drejtave të Njeriut, veçanërisht në territoret e uzurpuara, territoret e aneksuara.....apo vetë vende anëtare të cilat nuk i përmbushin ato plotësisht kur flitet për gazetarë, pakica, apo pjesë të shoqërisë të cilat janë të stresuara dhe nga ndryshimi i klimës politike në Evropë deri tani. Faleminderit!*

Xhemal Qefalia – Fjala për ju.

Erinda Bllaca Ndroqi – *Pyetja juaj ishte pak e gjerë në përgjithësi...*

Ervin Bushati – *Kështu do të jetë edhe detyra juaj..*

Erinda Bllaca Ndroqi – *Jam shumë në dijeni të detyrave të CPT-së që lidhen me situatat të vështira, pozicioni i anëtarit të CPT-së duhet të jetë shumë i drejtë, i paanshëm dhe profesional në çdo situatë, sidomos kur është fjala për privimin, p.sh. një paraburgim i paligjshëm, apo heqja e lirisë së atyre ... në konflikt apo në situatë të vështirë, në këtë rast të emigrantëve. Në mandatin e CPT-së monitorimi i ambienteve të paraburgimit dedikuar emigrantëve është pjesë*

e përgjegjshmërisë dhe unë mendoj se standardet, që lidhen ose jo me një vend të veçantë, duhet të respektohen dhe mbështeten plotësisht. Ne flasim për një komitet, qasja kryesore e të cilit është kundër torturës, trajtimit dhe ndëshkimit çnjerëzor dhe denigrues. Pra ne po flasim për një të drejtë universale, e cila në çdo situatë apo në çdo kohë ka të gjitha llojet e kufizimit, pra është universale, e paprekshme dhe shtetet kanë të drejtë të pranojnë dhe njohin plotësisht përgjegjësitë në çdo rrethanë të veçantë.

Xhemal Qefalia – Faleminderit!

Fjalën e ka zonja Gjermani!

Eglantina Gjermani – Faleminderit për prezantimin!

Suksese në kandidimin për këtë pozicion kaq të rëndësishëm.

Unë dua të di si e mendoni rolin tuaj nëse përzgjidheni në këtë pozicion dhe cili do të jetë kontributi juaj konkret për përmirësimin e standardeve të të drejtave të njeriut në Shqipëri? Pra, si do të ndikosh ose do të rekomandosh në institucionet në Shqipëri për përmirësimin e punës së tyre dhe respektimin e të drejtave të njeriut?

Faleminderit!

Erinda Bllaca Ndroqi – Faleminderit për pyetjen!

Për sa i përket pjesës së angazhimit personal në përmirësimin e situatës së të drejtave të njeriut, mbrojtjen dhe garantimin e standardeve të të drejtave të njeriut, e kam pasur pjesë të punës sime për shumë vite. Unë mendoj se çdo praktikë e mirë mund të jetë benefit për vendin. Pozicionin tim gjatë gjithë karrierës sime profesionale e kam orientuar drejt mbrojtjes së të drejtave të njeriut, kryesisht ndaj personave që nuk janë aq të favorizuar ose konsiderohem të margjinalizuar nga sistemi. Mendoj se pozicioni për pjesën e Komitetit të Parandalimit të Torturës, ne e dimë që imparcialiteti, profesionalizmi, shkëputja ose mbajtja e një stature qoftë edhe nga ana e integritetit individual apo personal, është thelbi i një anëtari të CPT-së.

Në çdo moment ai që do të zgjidhet, kushdo qoftë ai nga ana e kandidatëve sikurse u prezantuan në mëngjes, duhet ta ketë parasysh, sepse ne nuk jemi këtu vetëm si profesionistë, por jemi edhe në emër të shtetit kur bëhet fjalë për këtë, por mbi të gjitha për çështjen e të drejtave të njeriut, të cilat jo në çdo rast janë konkrete siç mund të jenë të shkruara në konventa apo në legjislacion.

Xhemal Qefalia – A ka pyetje të tjera për zonjën Bllaca?

Nuk ka.

Zonja Bllaca, faleminderit dhe suksese!

Fjalën e keni ju zonja Hysi, për pjesën e dytë.

Vasilika Hysi – Faleminderit!

Në fakt, komisioni nuk do të bëjë vlerësim, sepse së bashku me komisionin i pranishëm është edhe delegacioni i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës. Në bazë të rezolutës së Këshillit të Europës delegacioni është i detyruar të jetë i plotë. Kolegët e opozitës mungojnë, sepse deputetët e rinj ende nuk janë ndarë nëpër delegacione. Të pranishëm në komision janë zonja Xhembulla, zonja Bushka, zoti Bushati dhe zonja Gjermani.

Pika e dytë, më falni që ju mbajta edhe ju, por kjo ka lidhje me punën që bëni, Nënkomisioni i të Drejtave të Njeriut ka hartuar një kalendar dhe plan masash për zbatimin e planit të veprimit të Kuvendit të Shqipërisë lidhur me rekomandimet e progres raportit të BE-së në fushën e të drejtave të njeriut dhe rezolutën për objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm. Kalendarin u është shpërndarë të gjithë anëtarëve të komisionit dhe në të janë një sërë aktivitetesh, një pjesë e të cilave do të bëhet me institucionet e pavarura kushtetuese ato të krijuara me ligj, me Komisionin e Ligjeve apo Nënkomisionin që drejton zonja Gjermani për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës, si dhe me Nënkomisionin për Qeverisjen Vendore.

A janë dakord anëtarët e komisionit? Po.

Gjithashtu, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar rezolutën për mbrojtësit e të drejtave të njeriut. Është ngarkuar Nënkomisioni i të Drejtave të Njeriut për të ndërmarrë takimin e parë, si dhe të hartojë raportin e parë kombëtar për gjendjen e mbrojtësve të të drejtave të njeriut. Në bazë të rezolutës këshilltarja e komisionit ka hartuar kalendarin e veprimtarive që ne duhet të bëjmë.

E para, është një takim i përbashkët i të gjithë mbrojtësve të të drejtave të njeriut dhe organizatave të të drejtave të njeriut, si dhe institucioneve të tjera që punojnë në fushën e të drejtave të njeriut, përfshirë këtu organizatat vendase dhe ato ndërkombëtare, për të përmbushur rekomandimin ose detyrimin e parë që buron nga rezoluta, që është identifikimi i problematikave dhe vështirësive të hasura gjatë veprimtarisë së mbrojtësve të të drejtave të njeriut, të drejtave të grupeve të marginalizuara, në veçanti grave, fëmijëve, personave me aftësi të kufizuara, viktimave të dhunës së trafikimit, pjesëmarrësve të pakicave kombëtare, komunitetit LGBTI-së, refugjatëve, emigrantëve dhe popullatave në lëvizje. Në bazë të kalendarit dhe vendimit të Kuvendit të Shqipërisë kërkesa për bashkëpunim do të përcillet nga ana e nënkomsionit të të Drejtave të Njeriut me firmën time brenda muajit maj, por unë do t'jua nis menjëherë brenda javës që vjen me qëllim që ta vëmë punën në vijë edhe për shkak se më 30 qershor janë zgjedhjet dhe mund të ketë angazhimeve të tjera qoftë nga ana e deputetëve,

por edhe nga ana strukturave sidomos të OSBE-së, të Këshillit të Europës, Bashkimit European, si dhe institucione të tjera që monitorojnë proceset zgjedhore.

E dyta, të gjithë bashkë kemi një detyrim si nënkomision, por edhe ju si përfaqësues të institucioneve dhe të shoqërisë civile, që të gjitha rekomandimet, shqetësimet, problematikat që kenë adresuar në punën tuaj t'i depozitoni pranë Nënkomisionit për të Drejtat e Njeriut. Pra, lista e rekomandimeve, raporteve dhe gjetjeve tuaja lidhur me mbrojtësit e të drejtave të njeriut për të bërë identifikimin e vështirësive dhe për të draftuar rekomandimet që do t'i përcillen Komisionit të të Drejtave të Njeriut e më pas seancës plenare. Afati është qershori i 2019-ës prandaj është një periudhë e kufizuar.

E treta, raportimi në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut. Këtë raport e depoziton Nënkomisioni i të Drejtave të Njeriut, por raportin do të bazohet në një punë të përbashkët që do të bëjë nënkomisioni së bashku me shoqërinë civile dhe me institucionet e pavarura kushtetuese ose të krijuara me ligj, si dhe bazuar edhe në konsultimin publik që do t'i bëhet draft-raportit me institucionet, organizatat dhe grupet shoqërore. Ne si nënkomision kemi një praktikë shumë të mirë, pasi ne do të ftojme edhe grupet e interesit jo vetëm organizatat, por edhe komunitetin rom, komunitetin egjiptian, LGBT-në, personat me aftësi të kufizuar, si dhe shumë të tjerë.

Meqë në komision është e pranishme zëvendësministrja e Shëndetësisë dhe e Çështjeve Sociale, zonjën Kospiri, do ta vlerësoja shumë kontributin dhe angazhimin e ministrisë suaj me qëllim që raporti të jetë jo vetëm i detajuar ashtu siç kërkohet, por të jetë edhe analitik dhe të adresojë një angazhim konkret të Kuvendit të Shqipërisë.

Gjithashtu, do të ftohen të gjitha universitetet. Kuvendi i Shqipërisë ka nënshkruar 23 marrëveshje me universitetet shqiptare, me Universitetin e Tiranës, me Universitetin e Shkodrës, Universitetet e Korçës, Durrësit dhe Elbasanit, të gjitha universitetet ku ka departamente të shkencave sociale, të drejtësisë, si dhe të tjera. Unë mendoj se edhe për këto universitete kjo do të jetë mënyra më e mirë për të vënë në zbatim marrëveshjet që ka nënshkruar Kuvendi i Shqipërisë për bashkëpunimin me profesoratin në nivelin e ekspertëve, por edhe me studentët dhe pedagogët.

Dua të falënderoj në mënyrë të veçantë pedagogët e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, sepse ky është bashkëpunimi juaj i parë me Kuvendin e Shqipërisë dhe për këtë arsye e vlerësojmë shumë praninë tuaj në këtë proces dhe mendoj se ka qenë një përvojë shumë e bukur.

A jeni dakord për këto tri pika të kalendarit që burojnë nga rezoluta për njohjen dhe mbështetjen e veprimtarisë së mbrojtësve të të drejtave të njeriut, promovimin, nxitjen,

mbrojtjen e të drejtave të njeriut, forcimin e shtetit të drejtë dhe konsolidimin e demokracisë?
Dua t'ju bëj me dije se votojnë vetëm anëtarët.

Dakord.

Shumë shpejt do të thirret një tryezë e konsultimit publik me të gjithë aktorët shtetërorë, institucionet e pavarura dhe shoqërinë civile, medien, me të gjithë mbrojtësit e të drejtave të njeriut, edhe medien investigative, për të filluar dhe për të draftuar aksionin e mbrojtësve të të drejtave të njeriut.

Po, urdhëroni!

Ervin Bushati – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit për pjesëmarrjen dhe kontributin!

Ne e vlerësojmë lartësisht këtë iniciativë, jo vetëm sepse jemi anëtarë me të drejta të plota, por nuk ka asnjë arsye që edhe një vend i vogël, si Shqipëria, me të gjitha problemet ekonomike që mund të ketë, të mos paraqitet sa më denjësisht në një institucion kaq të lartë. Ne duam të respektojmë pikërisht nivelin e Shqipërisë sonë, nivelin tuaj, për të çuar njerëzit më të mirë, ndaj jemi përpjekur të bëjmë një strukturë dhe një proces sa më të hapur, sa më gjithëpërfshirës. Ju i patë vetë kandidatët dhe shpresojmë të jemi në një mendje që të përzgjedhim dhe të çojmë atje tre më të mirët që do të votohen patjetër, sepse është në respektin, në dinjitetin dhe në punën tonë që të kemi përfaqësuesin më të mirë. Nuk është thjesht situatë në Shqipëri, por edhe ndërkombëtare, ndaj mirëpresim çdo sugjerim që mund të keni me shkrim për kandidatët që u paraqitën dhe i patë edhe ju vetë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

I falënderoj edhe për kohën, sepse e bën edhe më shumë dinjitoz këtë proces! Nuk kemi asnjë arsye të mos këta i kemi në lartësinë e vendeve që i mirëpresin. Pavarësisht se ne nuk përmbushim dot standarde ekonomike, nuk na pengon asgjë të kemi të njëjtin standard politik, së pari, juridik, njerëzor, për një proces kaq të rëndësishëm. Pra, të jemi në lartësinë e atyre që na kanë pranuar e të drejta të plota, por edhe në lartësinë e qytetarëve që na besojnë për këtë punë.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Duke deklaruar mbylljen e mbledhjes, do të doja shumë t'ju falënderoja të gjithëve ju për pjesëmarrjen tuaj, që iu përgjigjët pozitivisht këtij procesi që zhvillohet për herë të parë në Kuvendin e Shqipërisë në 28 vjet! Uroj të jetë proces që do të vijojë me të gjitha kandidaturat për institucionet dhe komitetet e tjera!

Jeni të mirëpritur të jepni mbështetjen dhe opinionin tuaj. Përfaqësuesi i Shqipërisë, që do të kontribuojë në respektimin e lirive dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut duhet të jetë më i miri i mundshëm.

Gjithashtu, për shkak të angazhimit të ka zonja Papa, si eksperte për Këshillin e Europës, do të detyroheni edhe një herë ditën e hënë të jeni të pranishëm në orën 12:00. Nuk do të vonohemi më shumë se 15-20 minuta. Jemi të detyruar ta lëmë në atë orë për shkak të angazhimeve të tjera që deputetët kanë në komisione dhe nënkomisione. Takimi do të bëhet sërish këtu.

Ju lutem, sekretaria e Kuvendit, të bëjë njoftimin e medias. Besoj se ju nuk keni nevojë për njoftim.

Ju lutem, pedagogët, të qëndrojnë 2 minuta!

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA